

**UNIVERSITETI “ISA BOLETINI”
MITROVICË**



ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË

**Raport për pyetësorët e
realizuar me studentët e
Fakultetit të
Inxhinierisë Mekanike
dhe Kompjuterike**

**NIVELI MASTER
(Semestri dimëror)**

Shkurt, 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrja	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)	5
Realizimi i pyetësorit	5
Gjetjet e pyetësorit.....	6
Rekomandimet	20

Lista e shkurtesave

IAL:	Institucion i Arsimit të Lartë
KQSCV:	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit
SEVC:	Sistemi Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë
SMU:	Sistemi i Menaxhimit Universitar
UIBM:	Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë
ZSC:	Zyra për Sigurim të Cilësisë
FIMK:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

Hyrja

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (këtu e tutje: UIBM), si Institucion i Arsimit të Lartë (Këtu e tutje: IAL) themeluar që nga viti 2013, vazhdimisht ka bërë përpjekje që të bëjë të matshëm procesin e sigurimit të cilësisë. Për çdo vit, në UIBM janë organizuar pyetësorë me studentë dhe akterë tjerë relevant, të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë pasur për qëllim të tregojnë gjendjen reale në UIBM përmes përceptimit të respondentëve.

UIBM ka mekanizmat e tij për matjen e cilësisë, dhe përveç që procesi matet dhe monitorohet në vazhdimësi nga ana e dekanëve, prodekanëve, koordinatorëve për cilësi në kuadër të fakulteteve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (Këtu e tutje: ZSC) ka një rol të veçantë në këto zhvillime, dhe është organi kryesor brenda UIBM për matjen e cilësisë së brendshme.

Në muajin Janar 2022, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda UIBM, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në UIBM, përmirësimit të mësimdhënies si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm përkitazi me metodologjitë e reja, dhe rritjes së përgjegjësisë së stafit menaxhues, ZSC-ja ka realizuar pyetësorin me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të UIBMsë, në nivelin Master, në përfundim të semestrit dimëror, si një proces tashmë i zakonshëm.

I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë unanimit duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur prestigjin e institucionit.

Më poshtë, do të paraqesim të dhënat që janë nxjerrë nga pyetësori. Me qëllim që raporti të ruaj etikën e secilit dhe atë të institucionit, do të gjeni të publikuara vetëm disa nga gjetjet kryesore të pyetësorit. Rekomandimet si pjesa e fundit e tij, do të përmbajnë edhe sygjerime e vërejtje të cilat nuk bëhen publike, por që janë dhënë nga ana e respondentëve.

Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)

Zyra për Sigurim të Cilësisë është zyrë e pavarur e cila funksionon brenda Rektoratit të Universitetit të “Isa Boletini” në Mitrovicë (tutje UIBM) e cila raporton drejtpërdrejt te Rektori i UIBM. ZSC angazhohet në rritjen e cilësisë në UIBM duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar nga Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit (tutje KQSCV). Zyrtarët e cilësisë nuk janë pjesë e stafit akademik të UIBM.

Zyra kryen matje të cilësisë duke përdorur të gjitha instrumentet e përfshira në pakon e instrumenteve matëse të cilësisë e aprovuar nga KQSCV. ZSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Rektori i UIBM. Zyra gjithashtu i dërgon gjetjet dekanëve të njësive akademike me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Realizimi i pyetësorit

Pas përfundimit të ligjëratave dhe ushtrimeve për semestrin dimëror 2022, ZSC ka lansuar pyetësorin me të gjithë studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, niveli master në të gjitha programet, nga data 5 Janar deri më 28 Janar 2022. Pyetësori ka qenë anonim dhe të dhënat janë mbledhur dhe ruajtur nga ZSC përmes Sistemit Elektronik për Vlerësimin e Cilësisë - SEVC. Studentët janë përgjigjur përmes Sistemit të Menaxhimit Universitar (tutje SMU) në pyetësorin i cili ka përmbajtur 24 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur, ku kanë vlerësuar programin e studimit dhe mbështetjen në punën hulumtuese.

Pyetësori ka qenë i ndarë në dy nivele:

- Programi i studimit dhe
- Mbështetja në punën hulumtuese

Pyetjet kanë pasur për qëllim që të shohin këto aspekte kryesore:

- Kurrikula e programit

- Zhvillimi i mendimit kritik
- Konsultimet me mentorin dhe kontributi i tij;
- Qasjen e mësimdhënësve ndaj studentëve;
- Metodatat e mbajtjes së mësimi online;
- Rezultatet e të nxënësve.

Gjetjet e pyetësorit


Pyetësori është plotësuar nga të gjithë studentët që kanë paraqitur provimet në afatin e rregullt të provimeve në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, niveli Master. ZSC ka shpërndarë pyetësorin për të gjithë stafin akademik të FIMK dhe kemi marrë 193 përgjigje nga studentët, ku pjesëmarrja e studentëve në pyetësorë konsiderohet shumë e kënaqshme.

Nga të gjeturat studentët kanë qenë të sigurtë në përgjigjet e tyre, dhe kemi pranuar shumë komente dhe sugjerime që tregojnë interesimin e tyre që të kontribuojnë në proceset në UIBM.

Ky raport shpreh vetëm statistikën e përgjithshme, dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve. Ndërsa, raportet për fakultetet veç e veç, si dhe për secilin profesor, ZSC-ja i ka dërguar tek Dekanët e fakulteteve, dhe ata do t'i diskutojnë gjetjet me stafin e tyre akademik.


Diagrami i parë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me pyetjen nëse materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve ishte i qartë, ku më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, më pak se një e treta me mirë, dhe një numër i vogël kanë vlerësuar mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022 ishte i qartë.

1. Materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve ishte i qartë



Diagrami i dytë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me metodat e mësimdhënies, ku më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar maksimalisht, më pak se një e treta kanë vlerësuar me mirë, dhe një numër i vogël i studentëve kanë vlerësuar mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi, sipas rezultateve metodat e mësimdhënies të përdorura gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022 ishin moderne apo bashkëkohore.


2. Metodatat e mësimdhënies kanë qenë bashkëkohore



Diagrami i tretë me rradhë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me njohuritë e mësimdhënësve për lëndën, ku më shumë se gjysma e studentëve kishin dhënë vlerësimin maksimal, më


pak se një e treta mirë, dhe një numër i vogël janë përgjigjur me mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në bazë të rezultateve, mund të themi se mësimdhënësit kanë treguar njohuri të materies së lëndës.

3. Mësimdhënësi/ja demonstron njohuri të materies së lëndës




Tutje, diagrami i katërt shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me raportin ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, pak më shumë se një e treta mirë dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës ka qenë adekuat.

4. Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të lëndës ka qenë adekuat




Diagrami i pestë, shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me ndërveprueshmërinë e ligjëratave dhe ushtrimeve, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, pak më shumë se një e treta mirë, dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se ligjëratat dhe ushtrimet gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022 kanë qenë ndërvepruese.




Diagrami i gjashtë shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me përmbajtjen e lëndës, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, pak më shumë se një e treta mirë, dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se studentët ishin të kënaqur me përmbajtjen e lëndës.

6. Në përgjithësi jam i/e kënaqur me përmbajtjen e lëndës




Diagrami i shtatë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me vlerësimin e aktiviteteve sipas syllabusit të lëndës, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, gati një e treta mirë dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se aktivitetet janë vlerësuar ashtu si ka qenë e paraparë në syllabusin e lëndës.

7. Aktivitetet (testet, ushtrimet, detyrat, projektet, punimi seminarik etj.) janë vlerësuar ashtu si ka qenë e paraparë në syllabusin e lëndës




Diagrami i tetë shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me ndërlidhshmërinë e ligjëratave me ushtrimet, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, një e treta mirë

dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se ligjëratat kanë qenë të ndërlidhura me ushtrimet.




Në vijim, diagrami i nëntë shpreh në përqindje përgjigjet e studentëve lidhur me lehtësinë e qasjes në klasat e mësimit online në SMU, ku pak më shumë se gjysma e studentëve kanë vlerësuar me shumë mirë, një e treta mirë dhe një numër i vogël janë përgjigjur mesatarisht, deri diku dhe aspak mirë. Në përgjithësi mund të themi se sipas studentëve qasja në klasat e mësimit online ka qenë e lehtë.




Diagrami i dhjetë shpreh përqindjen e përgjigjeve të studentëve lidhur me angazhimin e tyre për mësim në shtëpi ose bibliotekë për lëndët, ku gati një e treta e studentëve janë përgjigjur me 3-4 orë, pak më pak se një e treta 1-2 orë, një e pesta 5-6 orë dhe më pak se një e pesta mbi 7 orë.

10. Për të arritur sukses përveç ligjëratave, sa orë keni studiuar dhe jeni përgatitur në shtëpi ose bibliotekë për këtë lëndë?




Diagrami i njëmbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që testet janë mbajtur ashtu si ka qenë e planifikuar në syllabusin e lëndës.

11. Testet janë mbajtur ashtu si ka qenë e planifikuar në syllabusin e lëndës




Diagrami i dymbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që kanë qenë të lirë që vetë të përcaktohen për lëndët zgjedhore.

12. Studentët janë të lirë që vetë të përcaktohen për lëndët zgjedhore




Diagrami i trembëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që puna laboratorike/praktike është mbikqyrur vazhdimisht nga mësimdhënësi/asistenti i lëndës gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022.

13. Puna laboratorike/praktike mbikqyret vazhdimisht nga mësimdhënësi/asistenti i lëndës




Tutje, diagrami i katërbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që profesorët/asistentët kanë respektuar orarin e konsultimeve gjatë semestrit dimëror të vitit akademik 2021/2022.

14. Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e konsultimeve




Diagrami i radhës tregon në bazë të pohimit nga shumica e studentëve se mësime/lektoret e ka dërguar të gjitha materialet e ligjëratave në SMU apo email.

15. Mësime/lektoret e ka dërguar të gjitha materialet e ligjëratave në SMU apo email




Diagrami i gjashtëmbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar se mësime/lektoret e ka sqaruar syllabusin dhe e ka shpërndarë me kohë.

16. Mësimdhënësi/ja e ka sqaruar syllabusin e lëndës dhe e ka shpërndarë me kohë te studentët




Diagrami i shtatëmbëdhjetë me rradhë tregon se shumica e studentëve kanë pasur paisje për të ndjekur mësimin online.

17. Kam pasur paisje për të ndjekur mësimin online (telefon, laptop, kompjuter)




Diagrami i tetëmbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që kanë pasur qasje në internet për të ndjekur mësimin online.

18. Kam pasur qasje në internet për të ndjekur mësimin online




Diagrami i nëntëmbëdhjetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që mësimi online duhet të vazhdojë edhe në raste specifike gjatë vitit akademik.

19. Mësimi online duhet të vazhdojë edhe në raste specifike gjatë vitit akademik




Diagrami i njëzetë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që kanë zhvilluar punë hulumtuese/kërkimore.

20. Kemi zhvilluar punë hulumtuese/kërkimore




Diagrami i njëzetë e një tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që mësimitdhënësit i kanë motivuar për punë kërkimore.

21. Mësimitdhënësi/ja na ka motivuar për punë hulumtuese/kërkimore




Tutje, diagrami i radhës tregon se shumica e studentëve kanë pohuar që mësimitdhënësit kanë spjeguar eksperiencat e tyre nga puna hulumtuese/kërkimore.

22. Mësimdhënësi/ja ka spjeguar eksperiencat e tij/saj nga puna hulumtuese/kërkimore




Diagrami i njëzetë e tre me rradhë tregon se shumica e studentëve kanë pohuar se nëse do të mund të zgjedhnin përsëri, do të regjistroheshin prapë në të njëjtin program studimi.

23. Nëse do të mund të zgjidhnit përsëri tani, a do të regjistroheshit prapë në të njëjtin program të studimit?



Diagrami i fundit sa i përket pyetjeve të mbyllura, tregon se shumica e studentëve kanë pohuar se do ta rekomandonin programin e studimit për të tjerët marrë parasysh përvojën.

24. Duke pasur parasysh përvojën tuaj, a do të rekomandonit këtë program studimi për të tjerët?



25.

KOMENTE: Çfarë ndryshimesh do të sugjerorit me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe punës hulumtuese në kuadër të këtij programi të studimit?

Pyetje e detyrueshme.

Përgjigje e gjatë tekstuale (Paragraf teksti)

(193 përgjigje të postuara)

Komente:

- Të krijohet sa më shumë hapësirë për punë të pavarur kërkimore – shkencore, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit;
- Të ketë më shumë mundësi për punë praktike të studentëve edhe gjatë studimeve master;
- Më shumë komunikim dhe bashkëpunim në mes të mësimdhënësve dhe studentëve;
- Material shtesë;
- Vlerësimi i studentëve edhe gjatë ligjëratave;
- Mbajtja e mësimit gjatë fundjavës, për shkak të punës;

Rekomandimet

Zyra e cilësisë e UMIB, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, niveli Master në këtë pyetësor, dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të UIBM që të merren hapat si më poshtë:

- Të investohet vazhdimisht në rrafshin e hulumtimeve;
- UIBM të mundësojë nënshkrimin e sa më shumë marrëveshjeve për punë hulumtuese dhe praktike për studentët master;
- Të arrihen sa më shumë marrëveshje me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të studentëve;
- Të shikohen mundësitë financiare që vazhdimisht të bëhen investime në sektorin e IT-së dhe atë të laboratorëve;
- Komunikim i shtuar mësimitdhënës-student.
- Të shikohen mundësitë financiare që vazhdimisht të pasurohet biblioteka e UMIB, fizike dhe elektronike.